



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE  
KRYETARI

Nr. 2835/1 prot.

Tiranë, më 13.11.2020

Lënda: Dërgohet mendim për projektligjin “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 35/2016 “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”

**ZJ. ELVA MARGARITI**  
**MINISTRISË SË KULTURËS**

Rruga “Aleksandër Moisiu”, Nr. 76, ish Kinostudio “Shqipëria e Re”,  
Tiranë

E nderuar,

Pasi jemi njohur me shkresën tuaj nr. 3495 prot., datë 15.10.2020, administruar në Autoritetin e Mediave Audiovizive (AMA) me nr. 29351 prot., datë 19 tetor 2020, me lëndë: Njoftim dhe konsultim publik i projektligjit “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin n. 35/2016 “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”, bëjmë me dije sa më poshtë:

- Përmbajtja e neneve 1-5 të projektligjit ndryshues transpozojnë Direktivën 2012/28/BE “Për përdorime të caktuara të lejuara të veprave pa autor”. Në njohje të parashikimeve të direktivës së mësipërme, vërejmë se kjo direktivë ka të bëjë me *përdorime të caktuara të veprave pa autor nga bibliotekat, institucionet arsimore dhe muzetë, të aksesueshëm nga publiku si dhe nga arkivat, institucionet e trashëgimisë filmike ose audio dhe organizatat e transmetimit të shërbimit publik, të vendosura në Shtetet Anëtare, në mënyrë që të arrihen qëllimet që lidhen me misionet e tyre me interes publik.*

Nga shqyrtimi i propozimeve të bëra në projektligj, organizatat e transmetimit të shërbimit publik janë njësuar me OSHMA.

Referuar nenit 31, të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, OSHMA-të klasifikohen sipas formës së pronësisë mbi kapitalin e qëllimin e veprimtarisë, në shërbime publike, private, tregtare ose jotregtare.

RTSH, sipas ligjit organik të AMA-s është person juridik publik, jo me qëllim fitimi, që kryen shërbimet e transmetimit publik në fushën e shërbimeve audio dhe audiovizive në Republikën e Shqipërisë. Ndërsa OSHMA-të e tjera janë të organizuara në formën e subjekteve private dhe kanë karakter tregtar, me qëllim fitimi.

Në këto kushte, propozojmë zëvendësimin e termit “OSHMA”, kudo nw projektligj me termin “transmetuesin publik” duke mbajtur në konsideratë edhe përcaktimet e direktivës 2012/28

- Në nenin 3 të projektligjit, “neni 16/3”, “Burimet e kërkimit shterues”, përcaktohet:  
“ d) për veprat audiovizuale, shfaqjet, vprat e vendosura në fonograme dhe videograme:  
i) Depozitim ligjor.

Duke mbajtur në konsideratë se edhe në ligjin në fuqi, nr. 35/2016 “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to” nuk përkufizohet termi “depozitim ligjor”, propozojmë riformulim ose sqarim më të detajuar se çfarë nënkuptohet me depozitim ligjor.

- *Sa i përket përmbajtjes së nenit 6, që shton në ligjin ekzistues 2 nene për përdorimin e veprave me të drejtë autori nga personat e verbër me shikim të dëmtuar ose ndryshe më aftësi të kufizuara në leximin e materialeve të printuara, shprehemi dakord me përmbajtjen e tyre.*
- *Lidhur me përmbajtjen e neneve 7 dhe 8, që ndryshojnë parashikimet ligjore mbi Agjencitë e Administrimit Kolektiv të të Drejtave të Autorit.*

AMA, pasi është njohur me përmbajtjen e neneve dhe relacionin shpjegues të projektligjit, shprehet parimisht dakord me to dhe vlerëson pozitivisht këtë nismë, duke mbajtur parasysh problematikën e organizimit dhe funksionimit të deritanishëm të agjencive kolektive

Sjellim në vëmendjen tuaj se AMA, si autoritet rregullator në fushën e shërbimeve të transmetimeve audio dhe audiovizive dhe shërbimeve të tjera mbështetëse në Republikën e Shqipërisë, ka si detyrë monitorimin dhe mbrojtjen e një prej degëve të Pronësisë Intelektuale, konkretisht të të drejtave të transmetimit.

Gjatë ushtrimit të aktivitetit administrativ, AMA shpeshherë është ndeshur me ankesa të depozituara prej subjekteve OSHMA, lidhur me palët/subjektet me të cilat duhet të lidhin kontratat përkatëse për të drejtat e transmetimit, nëse duhet të jenë vetëm agjencitë e administrimit kolektiv apo mund të lidhen edhe me subjekte të tjerë, të cilët janë të autorizuar për mbledhjen e tarifave të shpërblimit për vepra, prodhime për të cilat subjekti ka të drejtën e përfaqësimit.

Në vlerësimin tonë, duhet parashikuar qartazi nëse subjektet që nënshkruajnë kontratë me SUADA-an, mund të transmetojnë çdo vepër artistike (filma apo muzikë) apo duhet të lidhin/nënshkruajnë marrëveshje/kontratë edhe për të drejtat e transmetimit.

Ky shqetësim është ngritur edhe prej subjekteve përsëritës, duke pretenduar se nuk duhet të paguajnë SUADA-an, kur thjesht ofrojnë ripërsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të një subjekti tjetër.

Po ashtu, për subjektet përsëritës (kabllor, satelit, rrjet IP (IPTV/OTT) në përcaktimin e tarifave, duhet që mbahet parasysh fakti që këto subjekte janë përsëritës të shërbimeve programore të OSHMA-ve.

Me ndryshimet e propozuara vërejmë së kjo problematikë nuk është trajtuar dhe me qëllim garantimin e të drejtave të OSHMA-ve por edhe zbatimin e drejtë dhe të plotë të dispozitave ligjore për të drejtën e autorit, propozojmë që në ndryshimet e ndërmarra të trajtohen edhe problematikat e ngritura prej shumë subjekteve OSHMA dhe subjekte përsëritës, përdorues të veprave dhe prodhimeve audiovizive.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin, ju urojmë punë të mbarë,

**KRYETARI**  
**Gentian Sala**

